



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORI

Tiranë, më 13.01.2021

**N J O F T I M**

Mbështetur në Vendimin e Rektorit, datë 13.01.2021 “Mbi rishpalljen e konkursit për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **13.01.2021 deri më 20.01.2021**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialiteteve ku aplikon.

**DEPARTAMENTI I SPORTIT**

<b>Moduli:</b> “Turizëm” (Bachelor)	2(dy) As/Lektor
<b>Moduli:</b> “Not” (Bachelor)	1(një) As/Lektor
<b>Modulet:</b> “Orjentim”, “Volejbolli” (Bachelor)	1(një) As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për As/Lektor në modulet përkatëse, në Departamentin e Sportit janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në nivelin Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Specialitetin e lëndës përkatëse ku konkuron. **15 pikë**
2. Të ketë notë mesatare të studimeve të larta mbi 8 (tetë). **15 pikë**
3. Të ketë përvojë pune Akademike mësimdhënëse e kërkimore në fushën përkatëse në Institucionet e Arsimit të Lartë. **25 pikë**
4. Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE : anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi. **10 pikë**.
5. Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë(me dëshmi). **10 pikë**
6. Kanë preference kandidatët që kanë Grada dhe Tituj shkencor. **15 pikë**
7. Të ketë kryer aktivitet shkencor si: referime, botime Brenda dhe jashtë vendit. **3 pikë**
8. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie. **1 pikë**
9. Të ketë eksperiencë praktike dhe specializim në fushat përkatëse. **3 pikë**
10. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës. **3 pikë**

- Kriteret nga 1 deri në 2 janë kriteret bazë dhe kandidati që nuk plotëson qoftë dhe njërën prej tyre skualifikohet. Kriteret nga 3 deri në 10 janë preferenciale.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
  - Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
  - Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
  - Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (fotokopje)
  - Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
  - Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
  - Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
  - Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
  - Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
  - Vërtetim nga qendra e punes per t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
  - Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).
- I. Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- II. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.
- III. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**R E K T O R**

**Prof. Dr. Agron KASA**